

VENDIM
Nr.15, datë 13.1.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.429, DATË 30.8.1993 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT QEVERTAR TË BISEDIMIT TË
BORXHIT TË JASHTËM”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit nr.429, datë 30.8.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

1. Komiteti Qeveritar i Bisedimit të Borxhit të Jashtëm, që më poshtë do të quhet “Komiteti”, ka këtë përbërje:

- Ministri i Financave	kryetar;
- Guvernatori i Bankës së Shqipërisë	zëvendëskryetar;
- Ministri i Drejtësisë	anëtar;
- Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	anëtar;
- Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave	anëtar;
- Drejtori i Departamentit të Operacioneve Monetare, në Bankën e Shqipërisë	anëtar;
- Ekspert, vendas apo i huaj	anëtar.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	

KRYEMINISTRI
Sali Berisha